

UDHËZIM
Nr. 1, datë 11.1.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E PROGRAMEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL QË
PËRFITOJNË NGA MBËSHTETJA FINANCIARE, PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 2, pika 2, e kreut I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 5.10.2022, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”,

UDHËZOJ:

1. Të përfitojnë nga mbështetja financiare për vitin 2024, programet e formimit profesional në fushën “Programim”.
 2. Në fushën “Programim” përfshihen: kodimi, programimi kompjuterik, zhvillimi i aplikacioneve, robotika, elektronika, shkenca e të dhënave, siguria kibernetike, inteligjenca artificiale, testimi i *software*-ve, dizajni i *software*-ve, dizajni i faqeve *web*, dizajni i përvojës së përdoruesit, dizajni i ndërfaqes së përdoruesit, mësimi makinerik/automatik, realiteti i shtuar, realiteti virtual ose algoritmet kompjuterike apo fusha të ngjashme të tjera.
 3. Fondet për zbatimin e këtij programi për vitin 2024 të mbulohen nga fondet e programit të nxitjes së punësimit.
 4. Udhëzimi nr. 1, datë 10.1.2023, “Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2023”, shfuqizohet.
 5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Ervin Mete